

# Teknologjia e zëvendësimit

për instaluesit



Mënyra e shpejtë dhe cilësore e përmirësimit të sistemeve R-22 dhe R-407C


# Ka përfunduar periudha e nxjerrjes graduale nga përdorimi të R-22. **Veproni tani!**

## Ndalimi i R-22 në Evropë

Shërbimi dhe mirëmbajtja e R-22 do të ndalohet pas datës 1 janar 2015, që do të thotë se do të jetë e pamundur të riparohen sistemet me R-22.

Shmangni periudhat e papritura të mosfunksionimit për klientët tuaj dhe zëvendësojini këto sisteme tani!

### Zgjidhja e Daikin për përmirësim me kosto të ulët



#### ✓ Ripërdorimi i tubave të kullimit

Tubat e fortë prej PVC-je mund të ripërdoren me lehtësi. Kërkohet vetëm testimi i qarkullimit.

#### ✓ Ripërdorimi i tubave të agjentit ftohës

Tubat e përdorur për R-22 funksionojnë edhe me VRV-Q, falë presioneve më të ulëta të funksionimit të sistemit.

#### ✓ Ripërdorimi i degëzimeve të tubave të agjentit ftohës

Nuk ka kufizime gjatë përmirësimit nga një sistem Daikin VRV. Sistemet e tjera VRF kërkojnë që degëzimet e tubave të durojnë një presion deri në 3,3 MPa.

#### ✓ Ripërdorimi i instalimeve elektrike të telekomandimit

Ripërdorni instalimet elektrike gjatë përmirësimit nga një sistem Daikin VRV. Në raste të tjera, kjo do të jetë në varësi të llojit të kabllot.

#### ✓ Ripërdorimi i instalimeve elektrike të brendshme/jashtme

Kufizimet: shikoni instalimet elektrike të telekomandës.

#### Vetëm zëvendësim:

##### ! Njësitë e brendshme dhe kutitë BS

Kontaktoni me shitësin tuaj lokal për të kontrolluar pajtueshmërinë në rast se keni nevojë të mbani njësitë e brendshme.

##### ! Njësitë e jashtme

# Historitë e suksesit me VRV-Q

## Pallati i Westminster, Mbretëria e Bashkuar

### Pse VRV-Q?

"VRV-Q ofron një opsion zëvendësimi me aftësinë unike për të reduktuar presionin e funksionimit të R-410A deri në nivelet e R-22, duke ruajtur performancën e R-410A."

**Mick Langford (All Seasons Climate Control, Shitës Daikin D1)**

- › Kursim energjie më shumë se 35%
- › Mbi 6 ton më pak CO<sub>2</sub> në vit
- › Viti i instalimit: 2012
- › Njësitë e instaluara: 3 njësi të jashtme VRV-Q, 13 njësi të brendshme
- › Zëvendësimi i sistemit të konkurrentëve



## Qendra e biznesit Torre Serenissima, Itali

### Pse VRV-Q?

"Zëvendësimi i plotë i sistemit 17 vjeçar me R-22 solli vetëm gjysmë dite pune humbje për punonjësit. Kontrolli i përmirësuar i qarkullimit të ajrit nga përdoruesi përmirësoi shumë komoditetin, duke reduktuar konsumin e energjisë me 25%."

**Maurizio Casarola (Administrator i Pronës)**

- › Kursim energjie 25%
- › Viti i instalimit: 2013
- › Njësitë e instaluara: 39 njësi të jashtme VRV-Q, 250 njësi të brendshme, 35 VAM 500, 4 kontrollues inteligjentë të prekjes (Intelligent Touch controllers)
- › Instalimi i plotë i kryer gjatë fundjavës



## Hotel Le Pigeonnet, Francë

### Pse VRV-Q?

Ristrukturimi i sistemit ekzistues VRV të një hoteli luksoz me 5 yje për t'i paraprirë nxjerrjes graduale nga qarkullimi të R-22.

- › Viti i instalimit: 2011
- › Njësitë e instaluara: 8 njësi të jashtme VRV-Q, 36 njësi të brendshme



# Këto përfitime do ta bindin klientin tuaj

## Gjithmonë funksional

### Shmangni humbjen e biznesit

Zëvendësimi tani parandalon periudhat e gjata të paparashikuara të mosfunksionimit të sistemeve të ajrit të kondicionuar. Kjo shmang gjithashtu humbjen e biznesit për dyqanet, ankesat nga klientët në hotele, efikasitetin e ulët në punë dhe humbjen e qiramarrësve të zyrave.

### Instalim i shpejtë dhe i thjeshtë

Pa ndërprerje të biznesit të përditshëm gjatë zëvendësimit të sistemit falë instalimit të shpejtë me montim me faza.

## Një zgjidhje me cilësi të lartë që do t'i rezistojë të ardhmes

Klientët mund të zëvendësojnë me kosto efektive sistemet nga prodhuesit e tjerë me teknologjinë me efikasitet të lartë dhe fleksibël të Daikin VRV me njësi të brendshme superiore me cilësi të lartë dhe komoditet të përmirësuar.



- › Shkarkim i ajrit 360°
- › Sensori opsional i pranisë dhe sensor i dyshemesë
- › Filtër opsional me pastrim automatik



## Gjurmë më të vogël, performancë më të lartë

Falë gjurmës më të vogël të tyre, njësitë e jashtme Daikin kursejnë hapësirën. Gjithashtu, më shumë njësi të brendshme mund të lidhen me një njësi të re të jashtme krahasuar me sistemin e vjetër, duke lejuar rritjen e kapacitetit.

## Një vendim që kursen kostot

### Më pak investim

Përmirësimi i sistemit kushton më pak, sepse është nevoja të zëvendësohen vetëm njësitë e brendshme dhe të jashtme. Kjo është mënyra më e shpejtë dhe më e lehtë për të qenë në pajtim me rregulloret e EPDB për ndërtesat.


### Mbrojtja e mjedisit

Efikasiteti i përmirësuar kursen energjinë dhe ul emetimet e CO<sub>2</sub>.

### Kosto më të ulëta afatgjata të instalimit

Direktivat e BE-së ndalojnë riparimet e sistemeve me R-22 pas 1 janarit 2015. Vonesa e zëvendësimit të nevojshëm të R-22 derisa të ndodhë një avari e sistemit, është një lojë ku vetëm mund të humbasësh. Dita për zëvendësim do të vijë. Instalimi i një sistemi të përparuar teknikisht ul konsumin e energjisë dhe kostot e mirëmbajtjes që nga dita e parë e instalimit.

## Deri në 48% më pak konsum



EER / COP	8HP	10HP
RXYQQ-T (R-410A)	4,30 / 4,54	3,84 / 4,45
RSXY-L7 (R-407C)	3,10 / 3,14	3,10 / 3,10
RSXY-KA7 (R-22)	2,37 / 2,95	2,37 / 3,00

Krahasimi i sistemeve 10HP:  
■ Regjimi i ftohjes  
■ Regjimi i ngrohjes

# Përfitimet e VRV-Q për të rritur fitimin tuaj

## Optimizimi i biznesit

### Më pak kohë instalimi

Aplikoni më shumë projekte brenda një kohe më të shkurtër falë instalimit më të shpejtë. VRV-Q është më me përfitim sesa zëvendësimi i sistemit të plotë me tubacion të ri.

### Kosto më të vogla instalimi

Reduktimi i kostove të instalimit ju mundëson t'u ofroni klientëve zgjidhje me kosto më efikase dhe të përmirësoni aftësinë tuaj konkurruese.

### Zëvendësimi i sistemeve jo Daikin

VRV-Q është një zgjidhje zëvendësuese jo problematike për sistemet Daikin dhe sistemet VRF të prodhuara nga prodhues të tjerë, gjë që ju mundëson të zgjeroni bazën tuaj të klientëve.

### E lehtë, si të numërosh deri në tre

Një zgjidhje e thjeshtë: Daikin VRV-Q ju mundëson të trajtoni më shumë projekte për klientët brenda një kohe më të shkurtër dhe t'u ofroni atyre çmimin më të mirë! Të gjithë fitojnë.

## Krahasoni hapat e instalimit

### Zgjidhja tradicionale

- 1 Rikuperimi i agjentit ftohës
- 2 Heqja e njësive
- 3 Heqja e tubacioneve të agjentit ftohës
- 4 Instalimi i tubacioneve dhe instalimeve të reja elektrike
- 5 Instalimi i njësive të reja
- 6 Testimi i rrjedhjes
- 7 Tharja me vakuum
- 8 Rimbushja e agjentit ftohës
- 9 Grumbullimi i kontaminimit
- 10 Testimi i funksionimit

### VRV-Q

- 1 Rikuperimi i agjentit ftohës
- 2 Heqja e njësive
- 3 Instalimi i njësive të reja
- 4 Testimi i rrjedhjes
- 5 Tharja me vakuum
- 6 Mbushja automatike me agjent ftohës, pastrimi dhe testimi

Ripërdorimi i tubacioneve dhe instalimeve ekzistuese elektrike



Deri në 45% më pak kohë instalimi

## Mbushje automatike me agjent ftohës

Mbushja me agjentin ftohës unik eliminon nevojën për të llogaritur volumin e agjentit ftohës dhe siguron që sistemi të funksionojë në mënyrë perfekte. Nuk përbën më problem mosnjohja e gjatësisë së saktë të tubacioneve për shkak të ndryshimeve apo gabimeve në rast se nuk i keni bërë ju instalimet origjinale, ose jeni duke zëvendësuar instalimet e një firme konkurrente.

## Pastrimi automatik i tubacioneve

Nuk është nevoja të pastrohet pjesa e brendshme e tubacionit duke qenë se kjo kryhet automatikisht nga njësia VRV-Q. Në fund kryhet automatikisht testimi i funksionimit për të kursyer kohë.



### Konveniençë me një prekje:

- › Matja dhe mbushja e agjentit ftohës
- › Pastrimi automatik i tubacioneve
- › Testimi i funksionimit

# Udhëzime kyçe

## për një zëvendësim cilësor me VRV-Q

### Tubacionet e degëzimit për agjentin ftohës

Tubacionet e degëzimit për agjentin ftohës, përfshirë ato nga prodhues të tjerë, Y-refnet, T-refnet dhe shpërndarës mund të ripërdoren sipas kushteve të mëposhtme:


- ✓ Tubacionet të jenë pa ndryshk
- ✓ Tubacionet të jenë të izoluar
- ✓ Tubacionet të durojnë një presion deri në 3,3 MPa
- ✓ Të mos ketë komponentë specialë që shkaktojnë dekompression (p.sh. kapëse vaji)
- ✓ Tubacionet e instaluar prej bakri të jenë në gjendje të përshtatshme (trashësia e tubacionit në përgjithësi i plotëson specifikimet, duke qenë se zgjidhja unike Daikin VRV funksionon me nivele presioni të ulët)

### Vaji ftohës

Tubat e gazit ftohës mund të ripërdoren nëse është përdorur një prej vajrave të mëposhtme: Barrel Freeze, Ethereal, Ester, Ferreol, HAB, MS, Suniso.

### Gjatësia maksimale e tubacionit dhe distancat e niveleve

VRV-Q mund të instalohet për sisteme tubacionesh me gjatësi totale prej deri 300 m. Shikoni ilustrimin e mëposhtëm për kërkesat e mëtejshme.



Gjatësia totale e tubacioneve:	300 m
Gjatësia më e gjatë e tubacioneve (1-7) aktuale/ekuivalente:	120 m / 150 m
Diferenca maksimale mes degëzimit më të shkurtër (A) dhe më të gjatë (B):	40 m



Shkarkoni broshurën e detajuar të të dhënave dhe mjetin krahasues të zëvendësimit VRV nga rrjeti ynë ekstranet për të llogaritur kostot e përdorimit.

Nëse keni pyetje apo kërkon informacion të mëtejshëm, ju lutemi kontaktoni me specialistin tuaj lokal të shitjeve për ndihmë eksperte.

Daikin Europe N.V. Naamloze Vennootschap · Zandvoordestraat 300 · 8400 Oostende · Belgium · www.daikin.eu · BE 0412 120 336 · RPR Oostende (Botues përgjegjës)

Publikimi aktual aktual është hartuar vetëm nëpërmjet informacionit dhe nuk përbën ndonjë ofertë detyruese për Daikin Europe N.V. Daikin Europe N.V. e ka hartuar përbajtjen e këtij publikimi me njohuritë e tij më të mira. Nuk jepet asnjë garanci e shprehur ose e nënkuptuar për plotësinë, saktësinë, besueshmërinë ose përshtatshmërinë për qëllime të veçanta të përbajtjes së saj dhe të produkteve dhe shërbimeve të paraqitura këtu. Specifikimet u nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim paraprak. Daikin Europe N.V. refuzon në mënyrë të qartë çdo përgjegjësi për dëmtim direkt ose indirekt, në kuptimin më të gjerë, i cili lind ose lidhet me përdorimin dhe/ose interpretimin e këtij publikimi. E drejta e autorit për të gjithë përbajtjen është e Daikin Europe N.V.

ECPSQ15-214

CD-02/15



Publikimi aktual zëvendëson publikimin ECPSQ14-115. Printuar me letër të paklorinuar. Përgatitur nga Platzer Kommunikation, Gjermani.